



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1589/
12 Prot.

Gjirokastrë, më 09/12/2020

V E N D I M

Nr. 39, datë 09.12.2020

**MIRATIMI I HAPJES SË PROGRAMEVE TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR",
PROGRAMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL DHE PROGRAMEVE TË
STUDIMIT NË CIKLIN E DYTË "MASTER", "MASTER PROFESIONAL" DHE
"MASTER I SHKENCAVE", PAS PËRFUNDIMIT TË REGJISTRIMEVE PËR VITIN
AKADEMIK 2020 - 2021**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë ", dhe në zbatim të udhëzimit nr. 15, datë 26.05.2020 , disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimit nr. 10, datë 15.05.2019, për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë i ndryshuar, udhëzimit nr. 17, datë 23.06.2020, për disa ndryshime në udhëzimit nr. 10, datë 15.05.2019 dhe udhëzimit nr. 17 datë 30. 07. 2019 , me nr. 7655/1 Prot. të MARS-së " Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimit nr. 10 datë 15.05.2019, Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë " , urdhërit të përbashkët nr. 02, datë 02.07.2020, për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve si dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2020 -2021, dhe urdhërit të përbashkët nr. 4, datë 30.09.2020 , për një ndryshim në urdhërin e përbashkët nr. 2 datë 02.07.2020 " Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2020-2021", si dhe

Vendimit nr. 418, datë 10.05.2017 "Për Standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre ", **Vendimit nr. 41, datë 24.01.2018** "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" dhe **Vendimit nr. 879 , datë 18. 12. 2019** , për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" ;

Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej në mbledhje e tij të datës, 09. 12. 2020, diskutoi rreth regjistrimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë që Universiteti "Eqrem Çabej " ofron për vitin akademik 2020 - 2021, pas përmbylljes të të gjitha fazave të regjistrimeve në zbatim të udhëzimeve të sipërcituar.

Pas diskutimeve për një numër të ulët të studentëve të regjistruar në programet e studimit në fushën e mësuesisë , e cila vjen si pasojë e rritjes së kriterit të notës mesatare në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 03.06.2020 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve në ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 e në vijim ", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej",

V E N D O S I :

1. Të miratojë hapjen e atyre programeve të studimit të cilat kanë një numër të ulët të studentëve të regjistruar për vitin akademik 2020 – 2021 të cilëve u shtohet edhe numri i studentëve sipas kategorive si mëposhtë:
 - Të transferuar
 - Me program të dytë studimi
 - Përsëritës në vitin e parë
 - Rifillim studimesh në vitin e parë.
2. Bashkangjitur këtij vendimi gjendet dhe tabela përmbledhëse për vitet e para në të gjitha programet e studimit që ofron Universiteti "Eqrem Çabej" .
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit "Eqrem Çabej".

REKTOR

Prof. dr. Bekdash MEMA

